

Bundeskanzlerin der Bundesrepublik Deutschland

Frau Dr. Angela Merkel MdB

Willy-Brandt-Straße 1

10557 Berlin

Hamburg, 10.04.2020

E nderuara Znj. Kancelare e Republikës Federale të Gjermanisë

E nderuara Znj. Dr. Angela Merkel

me anë të kësaj letre shoqatat me vendndodhje dhe të regjistruara në Gjermani, gjejnë rastin të shprehin falenderimet e tyre të thella Qeverisë Federale dhe juve personalisht për masat e ndërmarra në tejkalimin e krizës së shkaktuar nga pandemia e koronavirusit.

Ne dëshirojmë të shfrytëzojmë rastin të falënderojmë për përkrahjen e Kosovës gjatë tre dekadave të fundit, si gjatë apartheidit të regjimit të Millosheviçit, ashtu edhe gjatë luftës së Kosovës 1998-1999. Gjithashtu një falënderim i veçantë shkon për kontributin e shtetit gjerman në rrugëtimin e shtetndërtimit të Kosovës përgjatë dy dekadave të fundit.

Ne si nënshtetas/e gjermanë i jemi mirënjohës të përjetshëm Qeverisë Federale për mbështetjen e Kosovës në rrugën e ndërtimit të një demokracie funksionale, ku sundimi i ligjit dhe stabiliteti ekonomik janë kryefjala e saj.

Përveç luftës me virusin Covid-19, me të cilin Republika e Kosovës është duke u përballur këto ditë, fatkeqësisht edhe mosmarrëveshjet politike janë bërë temë e ditës. Ndërkohë që qeveria në detyrë është duke vepruar në ngadalësimin e shpërthimit të pandemisë, gjë të cilën e tregoi duke vepruar herët dhe rreptësisht, duke ndjekur të gjitha udhëzimet e OBSH-së, nga ana tjetër pjesë të elitës politike janë bërë së bashku për të shprehur dyshimet e tyre për qeverinë.

Vetëm për pak javë në detyrë, qeveria ishte në gjendje të ndërmarrë hapa të rëndësishëm të reformës. Për më tepër, si shenjë e vullnetit të mirë, qeveria hoqi plotësisht tarifatat për mallrat nga Serbia, të vëna nga qeveria e mëparshme, në mënyrë që të hyjë në një dialog me Serbinë sa më shpejt dhe të bëhet e mundur gjetja e një zgjidhjeje të përhershme.

Ministrat e të dyja palëve partiake janë ende duke punuar së bashku në mënyrë konstruktive. Mocioni i mosbesimit nuk u mbështet nga shumica e ministrave dhe as nga kryetarja e parlamentit.

Pasojat e mocionit të mosbesimit nënkuptojnë një pengesë të madhe për demokracinë e Kosovës dhe përpjekjet e Qeverisë Federale. Ky fenomen kërcënon të ketë një efekt destabilizues në të gjithë rajonin.

Ne druhami se zanafilla e kësaj mosmarrëveshjeje është diskutimi midis Presidentit të Kosovës dhe Presidentit të Serbisë për një zgjidhje me bazë etnike, duke bërë një shkëmbim tokash midis Kosovës dhe Serbisë. Ky është një plan që shkel parimet mbi të cilat bazohen dhe ndërtohen shtetet demokratike dhe Bashkimi Evropian. Integriteti territorial dhe funksionaliteti shtetëror i Kosovës nuk duhet të bëhen top loje e luftërave politike të brendshme për pushtet.

Me rëndësi është që prioritet për qeverinë në detyrë të Kosovës duhet të jetë ngadalësimi i përhapjes së pandemisë, derisa të kalojmë tek zgjedhjet e reja sipas kushtetutës.

Si qytetarë gjermanë me origjinë kosovare, ne jemi jashtëzakonisht të shqetësuar. Prandaj ju bëjmë thirrje: Bashkimi Evropian duhet të veprojë edhe një herë në mënyrë aktive në Ballkanin Perëndimor dhe të mbështesë ato forca politike në Kosovë, të cilat ruajnë dhe mbrojnë parimet tona demokratike, por gjithashtu sigurojnë stabilitet afatgjatë dhe zhvillim të qëndrueshëm në rajon. Negociatat duhet të menaxhohen nga Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Bisedime të tilla duhet të zhvillohen nga forca demokratike të ligjshme, që pasqyrojnë vullnetin e votuesve.

Ne mbështesim përpjekjet, me qëllimin për të gjetur një zgjidhje të përhershme të konfliktit midis Kosovës dhe Serbisë. Një zgjidhje afatgjatë dhe e përhershme e konfliktit u jep të dyja vendeve mundësinë për të qenë bashkërisht pjesë e procesit në Bashkimin Evropian dhe gjithashtu garanton paqe të qëndrueshme në Ballkanin Perëndimor. Ne do të dëshironim që Gjermania të luante një rol pionier në angazhimin e BE-së.

Në mënyrë që kjo të ketë sukses, ne jemi të mendimit se parimet e përcaktuara më poshtë duhet të respektohen:

1. *Gjatë dialogut, deri sa të arrihet një marrëveshje gjithëpërfshirëse midis Kosovës dhe Serbisë, Gjermania, si pjesë e trojkës dhe, veçanërisht me presidencën e Këshillit, së bashku me Shtetet e Bashkuara, duhet t'i kërkojë Serbisë që të përfundojë fushatën kundër shtetit të Kosovës. Kjo kërkesë do të mundësojë përparimin e dialogut.*
2. *Për më tepër, të dyja palët e përfshira duhet të njohin kufirin ekzistues midis Kosovës dhe Serbisë. Ndryshimet e kufijve të çdo lloji, të çojnë në mënyrë të pashmangshme në paqëndrueshmëri në rajon dhe nuk krijojnë një zgjidhje të përhershme, paqësore të mosmarrëveshjeve. Zhvendosjet e kufijve përgjatë vijave etnike do të kishin pasoja të paparashikueshme në Evropën Juglindore. Një zgjidhje e tillë mund të shërbejë si një precedent për aktorët e tjerë dhe të rrezikojë më tej stabilitetin në Ballkanin Perëndimor.*
3. *Bisedimet nuk duhet të çojnë në krijimin e një statusi të ri etnik ose ekstraterritorial brenda Kosovës. Shembulli i Bosnje-Hercegovinës na tregon se si një marrëveshje paqeje, pa marrë parasysh veçoritë dhe të veçantat lokale, do të thotë që njësitë etnike të krijuara bllokojnë pajtimin dhe të ardhmen e njëra-tjetrës.*
4. *Lufta e zhvilluar nga policia dhe ushtria serbe rezultoi me 13,000 vdekje. Pjesa dërrmuese e tyre ishin civilë. Mbi një milion njerëz janë shpërngulur dhe 20,000 gra u bënë viktime të dhunimeve seksuale . Njësitë ushtarake vendosën në shënjestër fshatrat, rrethet e tëra, shkollat, si dhe objektet fetare e spitalet, në të cilat hodhën zjarr dhe i dogjën ato. Deri më sot rezultojnë 1500 persona të zhdukur. Deri më sot, Serbia ka refuzuar të kërkojë një falje zyrtare dhe të marrë përgjegjësi për krimet e luftës. Për ta mundësuar pajtimin, Serbia duhet të kërkojë falje tek viktimat e luftës dhe tek të afërmit e tyre dhe gjithashtu ti dëmshpërblejë ato. Ata që kanë qenë të përfshirë në krimet e luftës duhet të japin përgjegjësi duke dalë përpara drejtësisë.*
5. *Rezultat i këtyre negociatave duhet të jetë njohja shtetërore e Kosovës nga Serbia. Vetëm në këtë mënyrë bëhet i mundur sigurimi i stabilitetit dhe mundësohet perspektiva e ardhshme për të dy vendet në rrugën e tyre drejt BE-së.*

Shpresojmë të kemi treguar, që edhe ne kosovarët të cilët jetojmë në Gjermani dhe gjermanët me një histori migracioni kosovare, jemi të interesuar për një Kosovë demokratike dhe të

prosperuar. Kjo mund të arrihet vetëm përmes një dialogu të ndershëm midis politikanëve legjitimë. Aktualisht demokracia në Kosovë është më e brishtë se kurrë, na duhen fjalë të qarta dhe gjithashtu mbështetja e partnerëve tanë është e domosdoshme.

Në pritje të një përgjigjeje Tuajën, ju falënderojmë paraprakisht.